



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jed'n. Org. Unit	01	Nr. Prot. B: Prot. Pr. L. No.	130
Nr. Faqeve Bz. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/130/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19, paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr.1/2024 për Trajnimin Fillestar.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Udhëheqësit të Divizionit për Trajnim Fillestar
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19, paragrafi 6 i Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur miraton këtë:

RREGULLORE NR. 1/2024
PËR TRAJNIMIN FILLESTAR

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton organizimin e trajnimit fillestar, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar, rolin e trajnuesve dhe mentorëve dhe marrëdhënien e tyre me Akademinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme Akademia) dhe kriteret për përfundimin dhe vlerësimin me sukses të trajnimit fillestar.

Neni 2
Përkufizimet

1. “Pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar/përfituesit e Programit të Trajnimit Fillestar” – gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar të shtetit të obliguar që të ndjekin Trajnimin Fillestar siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe në përputhje me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.
2. “Trajnues – eksperti i angazhuar për të zbatuar programin e trajnimit, siç përcaktohet me Rregulloren për Trajnuesit dhe Mentorët.
3. “Mentor” – një gjyqtar ose prokuror i shtetit i angazhuar që të mbështes pjesëmarrësit e Programit të Trajnimit Fillestar gjatë pjesës praktike të Programit siç është përcaktuar me Rregulloren për Trajnuesit dhe Mentorët.
4. “Trajnimi fillestar” – trajnimi i përcaktuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit.
5. “Kompetenca” - një kornizë e njohurive profesionale, aftësive praktike dhe qëndrimeve profesionale, të nevojshme për kryerjen e detyrave të një gjyqtari apo prokurori, siç përcaktohet nga Akademia.



Neni 4

Organizimi i Trajnimit Fillestar

1. Akademia është përgjegjëse për organizimin e Trajnimit Fillestar.
2. Akademia organizon Trajnimin Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar në koordinim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPK).

Neni 5

Programi i Trajnimit Fillestar

1. Përmbajtja e programit të trajnimit miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Programi i trajnimit synon zhvillimin e kompetencave në vijim:
 - 2.1. Kapacitetet profesionale të nevojshme për kryerjen e detyrave si gjyqtar dhe/apo prokuror;
 - 2.2. Aftësitë praktike për menaxhimin e çështjes/rastit, zhvillimin e një gjykimi dhe nxjerrjen e një vendimi të bazuar në ligj dhe interpretimin e duhur të fakteve të çështjes/rastit;
 - 2.3. Integritetin personal dhe sjelljen etike;
 - 2.4. Zbatimin e duhur të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
 - 2.5. Arsytimin e vendimeve gjyqësore;
 - 2.6. Aftësitë komunikuese.

Neni 6

Struktura dhe kohëzgjatja e Programit të Trajnimit Fillestar

1. Programi i Trajnimit Fillestar përbëhet nga trajnimi teorik dhe praktik në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
2. Kurrikula e trajnimit për trajnimin teorik të gjyqtarëve të sapoemëruar përbëhet nga modulet për të Drejtën Civile dhe Penale dhe temat mbi etikën gjyqësore dhe sjelljen profesionale, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Drejtën e BE-së dhe të Drejtën Ndërkombëtare.
3. Kurrikula e trajnimit për trajnimin teorik të prokurorëve të sapoemëruar përbëhet nga modulet për të Drejtën Penale dhe temat mbi etikën dhe sjelljen profesionale, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Drejtën e BE-së dhe të Drejtën Ndërkombëtare.



4. Struktura e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve të sapoemëruar është si më poshtë:

4.1.Pjesa e Drejtësisë Civile

- Trajnimi teorik 3 (tre) mujor për të Drejtën Civile
- Trajnimi praktik 3 (tre) mujor për drejtësinë civile në gjykata.

4.2 Pjesa e Drejtësisë Penale

- Trajnimi teorik 3 (tre) mujor për të Drejtën Penale
- Trajnimi praktik 3 (tre) mujor për drejtësinë penale në gjykata

4.3 Pjesa e Drejtësisë Penale dhe Civile

- Trajnimi teorik 6 (gjashtë) mujor për të Drejtën Penale dhe Civile
- Trajnimi praktik 6 (gjashtë) mujor për drejtësinë penale dhe civile në gjykata

4.4. Akademia, varësisht sipas kërkesës nga KGJK, mund të realizoj trajnimin fillestar sipas njërës prej strukturave të këtij Neni, pikat 4.1, 4.2 dhe 4.3 për secilën gjeneratë.

5. Struktura e Trajnimit Fillestar të prokurorëve të sapoemëruar është si më poshtë:

5.1.Trajnimi teorik 6 (gjashtë) mujor.

Trajnimi praktik 6 (gjashtë) mujor në Prokuroritë e shtetit.

5.2.Trajnim teorik 2 (dy) ditë në javë dhe

Trajnim praktik në prokuroritë përkatëse të shtetit 3 (tri) ditë në javë për 12 (dymbëdhjetë) muaj.

5.3. Akademia, varësisht sipas kërkesës nga KPK, mund të realizoj trajnimin fillestar sipas njërës prej strukturave të këtij Neni, pikat 5.1 dhe 5.2 për secilën gjeneratë.

6. Trajnimi praktik zhvillohet pas përfundimit të pjesës teorike përkatëse të Trajnimit Fillestar dhe organizohet në gjykatat dhe prokuroritë e instancës së parë nën mbikëqyrjen e mentorëve të caktuar, përveç për pikën 5.2 në të cilin rast pjesa praktike dhe teorike realizohen paralelisht.

7. Këshilli Drejtues i Akademisë miraton përmbajtjen e pjesës teorike dhe praktike të Trajnimit Fillestar.

8. Akademia është përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e Programit të Trajnimit Fillestar dhe performancën e trajnuesve dhe mentorëve.



Neni 7

Planifikimi dhe Organizimi i Trajnimit Fillestar

1. Trajnimi Fillestar planifikohet dhe organizohet nga Akademia në koordinim me KGJK-në dhe KPK-në.
2. KGJK dhe KPK kanë autoritetin për të përcaktuar numrin e pjesëmarrësve të trajnimit fillestar për secilin vit, varësisht nga numri i planifikuar i pozitave që do të rekrutohen. Ata duhet ta informojnë me kohë Akademinë lidhur me rezultatin e procesit të rekrutimit.
3. Akademisë i nevojiten maksimum 3 muaj për organizimin praktik të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e re të pjesëmarrësve të trajnimit fillestar, duke llogaritur nga përfundimi i procedurës së rekrutimit nga ana e KGJK/KPK-së dhe dërgimi i propozimeve tek Presidenti për emërim.

Neni 8

Orari i trajnimit

1. Trajnimi Fillestar organizohet gjatë ditëve të punës në lidhje me orarin zyrtar të punës së Akademisë, gjykatave dhe prokurorive.
2. Trajnimi mund të organizohet edhe gjatë fundjavave ose jashtë orarit të rregullt të punës, sipas legjislacionit në fuqi dhe me qëllim që të sigurohet zbatimi i plotë i programit të trajnimit.

Neni 9

Vijueshmëria

1. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar janë të obliguar të ndjekin programin për 12 muaj.
2. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar janë të obliguar të njoftojnë me shkrim (email apo formë tjetër) për mungesën në trajnim Akademinë, Kryetarin e Gjykatës/ Kryeprokurorin e Prokurorisë përkatëse dhe Mentorin, në lidhje me mungesën e tyre për arsye mjekësore ose për arsye të tjera të justifikuara.
3. Mungesa e përsëritur dhe e pajustificuar do të konsiderohet si bazë për nisjen e procedurave në përputhje me aktet normative relevante dhe Kodet e Etikës Profesionale.
4. Akademia është përgjegjëse për të monitoruar dhe regjistruar vijueshmërinë e rregullt e të gjithë pjesëmarrësve të Trajnimit fillestar.
5. Akademia përgatit raporte javore mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar gjatë Trajnimit Fillestar dhe e njofton KGJK-në dhe KPK-në në baza të rregullta.
6. Akademia zbaton rregullat e përcaktuara nga KGJK dhe KPK për shfrytëzimin e pushimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 10

Të Drejtat dhe Detyrimet e pjesëmarrësve në Trajnimin Fillestar

1. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar kanë të drejtë të ndjekin të gjitha kurset dhe pjesët e parapara në program dhe të kenë qasje në informacione rreth organizimit dhe ofrimit të trajnimit.
2. Gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar të cilët dështojnë të fillojnë ose e ndërpresin Trajnimin Fillestar për arsye të justifikuara objektive, kanë të drejtë të ndjekin trajnimin fillestar me gjeneratën e radhës sipas kërkesës së KGJK-së dhe KPK-së.
3. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar janë të obliguar të respektojnë ligjet, rregullat dhe rregulloret e aplikueshme në lidhje me zhvillimin e Trajnimit Fillestar.
4. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar janë të obliguar të respektojnë rregullat e brendshme të Akademisë dhe të mirëmbajnë siç duhet materialet dhe pajisjet e ofruara gjatë trajnimit.
5. Pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar janë të detyruar të respektojnë trajnuesit, mentorët dhe stafin e Akademisë si dhe kodin e veshjes së Akademisë, gjykatave dhe prokurorive gjatë trajnimit.

Neni 11

Kriteret për përfundimin me sukses të Trajnimit Fillestar

1. Vlerësimi i trajnimit bazohet në kriteret e mëposhtme të miratuara nga ana e Akademisë:
 - 1.1. Raporti i Vijueshmërisë nga Akademia (Shtojca nr. 5).
 - 1.2. Raporti i Trajnuesve mbi rezultatet e vlerësimit lidhur me kryerjen e moduleve të trajnimit (Shtojca nr. 4).
 - 1.3. Raportet e mentorëve (Shtojca nr. 2).
 - 1.4. Rezultatet e testimit dhe provimit përfundimtar (Shtojca nr. 1).
2. Akademia plotëson shënon në dosjet personale të të gjithë pjesëmarrësve rezultatet e arritshmërisë së tyre gjatë Trajnimit Fillestar dhe ia dorëzon informacionet në kopje fizike dhe në formë elektronike KGJK-së dhe KPK-së për qëllime të vlerësimit të mëtejshëm.



Neni 12

Trajnimi shtesë

1. Bazuar në rezultatet e Trajnimit Fillestar, KGJK dhe KPK mund të kërkojnë trajnime shtesë për pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar të cilët nuk e kanë përfunduar me sukses programin.
2. Kërkesa nga KGJK ose KPK për organizimin e trajnimit plotësues do të specifikojë kohëzgjatjen dhe fushat ose pjesët përkatëse të Trajnimit Fillestar të cilat duhen ndjekur.
3. Akademia është përgjegjëse për organizimin e trajnimit shtesë brenda 3 muajve pas dorëzimit të kërkesës nga ana e KGJK-së dhe KPK-së.
4. Në fund të trajnimit plotësues Akademia harton një raport për KGJK-në dhe KPK-në në përputhje me nenin 11. Këshillat vendosin nëse pjesëmarrësi i Trajnimit Fillestar në fjalë ka kryer me sukses Trajnimin Fillestar dhe për rrjedhën e veprimit në rast se ai/ajo nuk e ka kryer atë.

Neni 13

Statusi i pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar

1. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar janë gjyqtarë dhe prokurorë të sapoemëruar me status të pjesëmarrësit të Trajnimit Fillestar.
2. Gjatë Trajnimit Fillestar, pjesëmarrësit janë të obliguar të respektojnë legjislacionin në fuqi për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale dhe këtë Rregullore.
3. Pjesëmarrësit në Trajnimin Fillestar mund të marrin pjesë dhe të vëzhgojnë seanca gjyqësore dhe të kenë qasje në informacionet në lidhje me rastet gjatë pjesës praktike të trajnimit nën mbikëqyrjen e mentorëve.

Neni 14

Rregullat disiplinore

1. Në rast të shkeljes së kësaj Rregulloreje ose të rregullave disiplinore të miratuara nga KGJK dhe KPK, pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar do t'i nënshtrohen procedurave disiplinore në përputhje me aktet ligjore përkatëse.
2. Akademia është përgjegjëse të informojë KGJK-në dhe KPK-në lidhur me sjelljen e pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar dhe të njoftojë këshillat në rast të shkeljeve të vërejtura të rregullave disiplinore dhe të etikës profesionale.



Neni 15 Vlerësimi përfundimtar të Trajnimit Fillestar

1. Vlerësimi përfundimtar i Trajnimit Fillestar organizohet dhe administrohet nga Akademia e Drejtësisë, respektivisht Departamenti i Programit/ Divizioni i Trajnimit Fillestar të Akademisë, në bazë të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave dhe rregullave përkatëse të përcaktuara në Programin e Trajnimit Fillestar dhe aktet e tjera të aplikueshme të miratuara nga Akademia, KGJK dhe KPK.
2. Qëllimi i vlerësimit është të vlerësojë nivelin e kompetencave të zhvilluara në kuadër të trajnimit teorik dhe praktik dhe të konfirmojë kapacitetet profesionale dhe personale të pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar për të kryer detyrat e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë.
3. Akademia është përgjegjëse për të siguruar monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të Trajnimit Fillestar përgjatë tërë kohëzgjatjes së programit.

3.1. Vlerësimi bëhet në bazë të dokumenteve të mëposhtme me shkrim:

- **Raporti i Vijueshmërisë** mbi pjesëmarrjen në Trajnimin Fillestar në sesionet dhe aktivitetet e trajnimit gjatë pjesës teorike dhe praktike (i përgatitur nga Akademia dhe i plotësuar në fund të javës gjatë periudhës së Trajnimit Fillestar) (Shtojca nr. 5);
- **Raporti i Trajnuesve** mbi nivelin e arritjeve të pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar dhe zhvillimin e kompetencave të tyre gjatë pjesës teorike për modulet e trajnimit me të paktën 5 sesione në përputhje me Programin e Trajnimit Fillestar (Akademia ofron një shabllon të formularit i cili duhet të plotësohet dhe të ruhet në dosjet personale të pjesëmarrësve të trajnimit) (Shtojca nr. 4);
- **Raporti i Mentorëve** mbi përparimin e arritur në zhvillimin e kompetencave të nevojshme gjatë pjesës praktike të Trajnimit Fillestar (Akademia ofron një Formular Vlerësimi i cili plotësohet dhe ruhet në dosjet personale të pjesëmarrësve të trajnimit) (Shtojca nr. 2);
- **Rezultatet e provimit** pas përfundimit të Trajnimit Fillestar për prokurorët dhe pjesëve përkatëse të Drejtësisë Civile/Drejtësisë Penale për gjyqtarët (Shtojca nr. 1).
- **Raporti Përfundimtar Përmbledhës** i përgatitur nga Akademia mbi bazën e dokumenteve të renditura më sipër dhe i dorëzuar në KGJK dhe KPK.

3.2. **Provimi në fund të Trajnimit Fillestar për prokurorët dhe pjesëve përkatëse të Drejtësisë Civile/Drejtësisë Penale për gjyqtarët do të ketë formatin në vijim:**

- **Testi me shkrim** i përgatitur nga trajnuesit



- **Zgjidhja e një rasti real** të përzgjedhur nga trajnuesit dhe anëtarët e Panelit të Vlerësimit të mbështetur nga stafi i Akademisë bazuar në hulumtime dhe analizën e jurisprudencës gjyqësore.

3.3. Vlerësimi i gjyqtarëve të sapoemëruar përgjatë dhe në fund të Trajnimit Fillestar mbulon fushat e mëposhtme të kompetencës:

- 3.3.1. Rendin juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar
- 3.3.2. Të Drejtën Materiale Penale;
- 3.3.3. Ligjin e Procedurës Penale;
- 3.3.4. Të Drejtën Materiale Civile;
- 3.3.5. Të Drejtën Procedurale Civile;
- 3.3.6. Shkathtësitë Personale dhe Ndërdisiplinore;
- 3.3.7. Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese

3.4. Vlerësimi i prokurorëve të sapoemëruar përgjatë dhe në fund të Trajnimit Fillestar mbulon fushat e mëposhtme të kompetencës:

- 3.4.1. Rendin juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- 3.4.2. Të Drejtën Materiale Penale;
- 3.4.3. Ligjin e Procedurës Penale;
- 3.4.4. Shkathtësitë Personale dhe Ndërdisiplinore;
- 3.4.5. Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese

3.5. Vlerësimi përfundimtar pas përfundimit të pjesës teorike të Trajnimit Fillestar për prokurorët dhe pjesëve përkatëse të Drejtësisë Civile/Drejtësisë Penale për gjyqtarët, bëhet **në formën e testimit, i pasuar nga zgjidhja e një rasti**, që organizohen nga ana e Akademisë.

- 3.5.1. Trajnuesit e angazhuar për realizimin e programit të trajnimit hartojnë një sërë pyetjesh dhe testesh (deri në 30/40 teste të ndryshme me 100 pyetje të llojit të mbyllur (me përgjigje *PO/JO* ose me *opsione të kufizuara*). Proporcioni i pyetjeve është përcaktuar në Nenin 18;
- 3.5.2. Testimi organizohet në formë elektronike me përdorimin e platformës së Akademisë, përveç në rastet kur nuk ka mundësi teknike atëherë realizohet me shkrim (kopje fizike);
- 3.5.3. Akademia siguron caktimin me short të testeve, me pyetje të zgjedhura me short të cilat mbulojnë të gjitha fushat e kërkuara të kompetencës;
- 3.5.4. Të gjithë pjesëmarrësit në provimin përfundimtar kanë 1 orë/60 minuta për t'iu përgjigjur pyetjeve.
- 3.5.5. Rezultati i testimit gjenerohet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik, përjashtimisht në rrethanat e pikës 3.5.2, rezultati llogaritet manualisht.



- Anëtarët e Panelit Vlerësues e nënshkruajnë raportin e gjeneruar elektronik/ fizik me rezultatet e testit;
- 3.5.6. Akademia është përgjegjëse për organizimin e përzgjedhjes së një numri të rasteve nga trajnuesit, dhe anëtarët e Panelit Vlerësues të mbështetur nga stafi i Akademisë, bazuar në hulumtime dhe analizën e jurisprudencës gjyqësore. Rastet e përzgjedhura do të jenë nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatave Themelore/ Prokurorive Themelore dhe numri i rasteve civile dhe penale do të jetë i barabartë dhe vendimi përfundimtar do të jetë nga Gjykata Supreme apo Gjykata e Apelit. Pikërisht para provimit, një rast përzgjidhet me short përmes platformës elektronike të Akademisë dhe shpërndahet midis pjesëmarrësve të Trajnimit Fillestar. Gjyqtarët do të punojnë në një rast civil dhe në një rast penal, ndërsa prokurorët do të punojnë dy raste penale.
- 3.5.7. Të gjithë pjesëmarrësit në provimin përfundimtar i kanë 2 orë/120 minuta për zgjidhjen e rastit dhe hartimin e një vendimi, aktgjykimi, aktakuze apo akti tjetër përkatës të dhe të arsytuar, varësisht nga profili i pjesëmarrësit të Trajnimit Fillestar (gjyqtar apo prokuror) dhe lloji i çështjes/rastit. Gjyqtarët dhe prokurorët do t'i kenë 4 orë/240 minuta për të dyja rastet, apo rastet civile dhe penale do të zgjidhen në dy ditë të ndryshme.
- 3.5.8. Paneli vlerësues i provimit përfundimtar sipas nenit 16 është përgjegjës për të shqyrtuar, analizuar dhe përmbledhur rezultatet e provimeve dhe për të hartuar raportin përfundimtar të Vlerësimit.
- 3.6. Provimi për zgjidhjen e rasteve është anonim. Për të garantuar anonimitetin zbatohen rregullat e veçanta të mëposhtme:
- 3.6.1. Akademia i ofron pajisjet e nevojshme (llap top për të gjithë pjesëmarrësit dhe printerë në të gjitha sallat e trajnimit) gjatë provimit për ti shkruar dhe printuar (shtypur) vendimet lidhur me këto raste.
- 3.6.2. Pjesëmarrësit e printojnë punën e vet individualisht.
- 3.6.3. Pas përfundimit të punës së tij/saj në rast ose pas skadimit të kohës së provimit, çdo pjesëmarrës i Trajnimit Fillestar e shënon emrin e tij/saj, datën dhe temën e provimit në një fletë të ofruar paraprakisht, e nënshkruan atë dhe e mbyll fletën në një zarf të vogël jo të tejdukshëm.
- 3.6.4. Ky zarf, së bashku me punën me shkrim, vendosen personalisht nga pjesëmarrësi i Trajnimit Fillestar në një zarf të madh jo të tejdukshëm dhe mbyllet. Zarfi i madh i mbyllur i dorëzohet mbikëqyrësit nga radha e stafit të AD-së sipas nenit 16.
- 3.6.5. Seksioni përkatës i Panelit sipas nenit 16 i hap me short zarfet e mëdhenj dhe shënon të njëjtin numër në zarfin e vogël dhe në çdo fletë të punës me shkrim e cila gjendet në zarf.



- 3.6.6. Zarfet e vogla (të cilat janë ende të mbyllura) mbahen nga anëtari i stafit të Akademisë, anëtar i Panelit sipas nenit 16, dhe punimet me shkrim i dorëzohen seksionit përkatës të Panelit të provimit për qëllime të vlerësimit.
- 3.6.7. Çdo punim me shkrim vlerësohet nga të paktën dy anëtarë të seksionit përkatës sipas nenit 17.
- 3.6.8. Pas përfundimit të testit relevant me shkrim dhe zgjidhjes së rasteve dhe vlerësimit të tyre, seksioni përkatës i Panelit të provimit kontrollon integritetin e zarfeve të vogla, i hap ato, identifikon punimet me shkrim dhe shënon emrat dhe numrat e punimeve me shkrim në një protokoll për të shpалosur anonimitetin.

Neni 16

Administrimi i procesit të vlerësimit dhe siguria

1. Akademia themelon një Panel për Vlerësimin e Provimit Përfundimtar të përbërë nga 10 anëtarë nga radhët e trajnuesve të angazhuar në Trajnimin Fillestar.
2. Paneli i Vlerësimit është i ndarë në dy seksione: Drejtësia Penale (si për gjyqtarët ashtu edhe për prokurorët) dhe Drejtësia Civile (për gjyqtarët), të përbërë nga pesë anëtarë secili, varësisht nga kompetenca e tyre.
3. Paneli i Vlerësimit ka përgjegjësinë të mbikëqyrë dhe të sigurojë përgatitjen me kohë të provimit dhe përgatitjen e testeve dhe rasteve të nevojshme.
4. Hartimi i testeve të vlerësimit përfundimtar dhe përpilimi i rasteve kryhet në një mjedis të sigurt të mbrojtur nga ndikimet e jashtme.
5. Të gjithë anëtarët e Panelit Vlerësues dhe stafi i Akademisë janë të obliguar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit në dispozicion lidhur me përgatitjen dhe organizimin praktik të provimit.
6. Pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar do të marrin informacionin për ditën dhe kushtet e organizimit të provimit (testimit dhe zgjidhjes së rastit) të paktën dy javë më herët.
7. Informacioni do të publikohet në ueb-faqet e Akademisë, KGJK-së dhe KPK-së dhe do t'u dërgohet me shkrim të gjithë pjesëmarrësve të trajnimit.
8. Të gjithë pjesëmarrësit të cilët nuk mund të paraqiten në ditën e provimeve për arsye objektive (gjendje mjekësore që pengon pjesëmarrjen ose arsye të tjera të justifikuara personale) duhet t'i paraqesin kërkesë Drejtorit të Akademisë që t'i nënshtrohen provimit në një ditë tjetër. Drejtori i Akademisë do të informojë lidhur me vendimin e tij në afat prej tri ditësh.
9. Testimi dhe zgjidhja e rastit do të organizohet në një zonë me kushte komode dhe në të njëjtën kohë për të gjithë pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar. Akademia siguron pajisjet e nevojshme dhe asistencën e nevojshme teknike gjatë provimit për të parandaluar problemet



- teknike të cilat ndikojnë në performancën në kohë të duhur dhe cilësore të pjesëmarrësve në Trajnimin Fillestar.
10. Gjatë provimit, pjesëmarrësit e trajnimit kanë të drejtë të përdorin aktet ligjore përkatëse të ofruara nga Akademia.
 11. Drejtori i Akademisë është përgjegjës për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e duhur të provimit përfundimtar. Pjesëmarrësit nuk mund të kenë në dispozicion asnjë çantë dore, letër, çantë shpine, regjistratorë, stilolapsa, lapsa, fletore, telefona celularë, kufje, kompjuterë ose pajisje të tjera në dhomën e provimit. Drejtori e nënshkruan listën me rezultatet finale të provimit përfundimtar.
 12. Në rast të shkeljes, pjesëmarrësi/ët përkatës të trajnimit do përjashtohen nga mundësia që t'i nënshtrohen provimit.
 13. Për administrimin e provimit përfundimtar është përgjegjës Departamenti i Programit, respektivisht Divizioni për Trajnimin Fillestar për gjyqtar dhe prokurorë në kuadër të kompetencave sipas nenit 10 dhe 11 të Rregullores së Akademisë për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të Punës.

Neni 17

Kushtet dhe afatet për vlerësimin përfundimtar

1. Rezultatet e testimit elektronik gjenerohen në mënyrë automatike menjëherë pas testimit.
2. Rastet vlerësohen nga të paktën dy anëtarë të seksionit përkatës të Panelit Vlerësues sipas nenit 16, të parazgjedhur nga Paneli. Nota përfundimtare e testit është mesatarja e notave të tyre individuale. Nota përfundimtare e provimit është nota mesatare nga testi dhe rasti.
3. Kriteret e vlerësimit për rastet janë si vijon:
 - Zbatimi i të drejtës materiale
 - Zbatimi i të drejtës procedurale
 - Vlerësimi i provave
 - Arsyetimi ligjor dhe të shkruarit
 - Saktësia e përgjithshme e aktit (vendim, aktgjykim, aktakuzë).
4. Vlerësuesit vlerësojnë në mënyrë të pavarur të gjitha parashtrësit e pjesëmarrësve të trajnimit në një shkallë prej 10 pikësh (Shtojca nr. 1). Nota përfundimtare për rastin është mesatarja e notave të tyre individuale. Më pas ajo shumëzohet me 10 në mënyrë që të përputhet me shkallën standarde të vlerësimit prej 100 pikësh të Akademisë të përcaktuar në nenin 18, paragrafi 4.
5. Rezultatet e zgjidhjes së rastit shpallen jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pas datës së provimit.



6. Rezultatet përfundimtare të pjesëmarrësve të Trajnimit fillestar publikohen në faqen e internetit të Akademisë dhe u dërgohen të gjithë pjesëmarrësve në Trajnimin Fillestar përmes e-mailit.

Neni 18 **Pikët**

1. Vlerësimi i rezultateve të trajnimit bëhet veçmas për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar.
2. Pikët e mëposhtme paraqesin maksimumin për kompetencat përkatëse të gjyqtarëve të sapoemëruar, të vlerësuara gjatë testit, të cilat korrespondojnë me numrin e pyetjeve në testin nga fusha përkatëse:
 - a. Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar – 10 pyetje/pikë
 - b. Kodi Penal – 20 pyetje/pikë
 - c. Kodi i Procedurës Penale – 20 pyetje/pikë
 - d. E Drejta Materiale Civile – 20 pyetje/pikë
 - e. E Drejta Procedurale Civile – 20 pyetje/pikë
 - f. Aftësitë personale dhe ndërdisiplinore – 5 pyetje/pikë
 - g. Legjislacioni dhe shkathtësitë e tjera praktike – 5 pyetje/pikë
3. Pikët e mëposhtme paraqesin maksimumin për kompetencat përkatëse të prokurorëve të sapoemëruar, të vlerësuara gjatë testit, të cilat korrespondojnë me numrin e pyetjeve në testin nga fusha përkatëse:
 - a. Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar – 10 pyetje/pikë
 - b. Kodi Penal – 25 pyetje/pikë
 - c. Kodi i Procedurës Penale – 40 pyetje/pikë
 - d. Aftësitë personale dhe ndërdisiplinore – 15 pyetje/pikë
 - e. Legjislacioni dhe shkathtësitë e tjera praktike – 10 pyetje/pikë
4. Vlerësimi përfundimtar i rezultateve të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë Trajnimit Fillestar bëhet në këto nivele:
 - a. Nivel i pamjaftueshëm – konsiderohet nga 0-60 pikë
 - b. Nivel i mjaftueshëm – konsiderohet mbi 60-80 pikë (*vëmendje! kur rezultati është 60,01 deri në 60,99 ai duhet të konsiderohet 61 ; e njëjta gjë vlen për të gjitha shifrat*)



- c. Nivel i mirë - konsiderohet mbi 80-90 pikë
 - d. Nivel shumë i mirë – konsiderohet mbi 90-100 pikë
5. Për të konsideruar trajnimin fillestar të përfunduar me sukses, pjesëmarrësit e trajnimit duhet të kenë të paktën një nivel të mjaftueshëm si në test gjithashtu edhe në rast.

Neni 19 **Procedura e ankesave**

1. Pjesëmarrësit e Trajnimit fillestar kanë të drejtë të ankohen për rezultatet negative (vetëm niveli i pamjaftueshëm) të testimit dhe provimeve gjatë Trajnimit Fillestar brenda 3 (tri) ditëve pas shpalljes së rezultateve.
2. Këshilli Drejtues i Akademisë cakton në fillim të Trajnimit Fillestar të çdo gjenerate një Panel për Shqyrtimin e Ankesave. Paneli ka 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
 - Dy gjyqtarë
 - Dy prokurorë
 - Një anëtar të Këshillit Drejtues të Akademisë.
3. Pjesëmarrësit e Trajnimit Fillestar mund të kundërshtojnë vlerësimin teknik (llogaritjen e pikëve dhe rezultatet përfundimtare) ose elementet e tjera teknike të organizimit të Trajnimit Fillestar.
4. Paneli e shqyrton ankesën brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e ankesave dhe rekomandimin/et i dërgon në Këshillin Drejtues për vendim.
5. Nëse ankesa pranohet, bëhet korrigjimi i nevojshëm në listën e shpalljes së rezultateve. Nëse jo, parashtruesi i ankesës njoftohet për arsyet e refuzimit të kërkesës/ankesës.

Neni 20 **Dispozita Kalimtare**

Për gjeneratat që janë duke e ndjekur Trajnimin fillestar të filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, do të zbatohen Rregullorja për Trajnimin Fillestar 03/2017, Rregullorja nr. 07/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar dhe Rregullorja Nr. 01/2021 për plotësim ndryshimin e Rregullores 03/2017. Për gjeneratat që fillojnë Trajnimin Fillestar në vitin 2024, aplikohet kjo Rregullore.

Neni 21 **Hyrja në fuqi**

1. Rregullorja shfuqizon Rregulloren për Trajnimin Fillestar 03/2017, Rregulloren nr. 07/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar dhe Rregulloren Nr. 01/2021 për plotësim ndryshimin e Rregullores 03/2017.



2. Rregullorja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.



SHTOJCA 1

FORMULAR VLERËSUES (për zgjidhjen e rastit praktik në fund të çdo periudhe tre/gjashtë mujore të trajnimit teorik)

TË PLOTËSOHET NGA ANËTARËT E SEKSIONIT PËRKATËS TË PANELIT VLERËSUES TË PROVIMIT PËRFUNDIMTAR TË CILËT VLERËSOJNË RASTET

Emri i vlerësuesit	
Fusha e së Drejtës (civile, penale)	
Data e provimit	
Numri i testit të vlerësuar (zgjidhja e rastit/çështjes)	

Qëllimi i vlerësimit

Pas përfundimit të çdo periudhe 3/6 mujore të trajnimit teorik, pjesëmarrësit e trajnimit i nënshtrohen një vlerësimi në formën e një testi dhe zgjidhjes së një rasti praktik.

Qëllimi i vlerësimit është të sigurojë që në fund të trajnimit teorik gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës në trajnim të ketë arritur njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme.

Është identifikuar kompetenca kryesore, kundrejt së cilës duhet të vlerësohet gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës në trajnim, e cila është identike për pjesën praktike të trajnimit :

- I. Kapaciteti profesional gjyqësor ose prokurorial (kompetencat teknike dhe analitike);

Për të arritur një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe të drejtë, vlerësuesit duhet të marrin parasysh shkallën e mëposhtme të notimit:

Shpjegimi i notave:

Notat 1, 2, 3, 4: Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit nuk ka zotëruar as një minimum të kompetencës. Ai/ajo nuk është në gjendje të demonstrojë njohuritë/ aftësitë / sjelljen e nevojshme madje as me mbështetjen e një mentori.



Nota 5: Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka zotëruar një minimum të kompetencës. Ai/ajo është në gjendje të demonstrojë njohuritë/ aftësitë /sjelljen e nevojshme vetëm me mbështetjen e një mentori.

Nota 6 : Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka zotëruar kompetencën mbi nivelin minimal. Ai/ajo është në gjendje të demonstrojë njohuritë/ aftësitë /sjelljen e nevojshme në mënyrë të kënaqshme, duke pasur nevojë për mbështetjen e konsiderueshme të mentorit.

Nota 7 : Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit e ka zotëruar kompetencën në një nivel të mirë. Ai/ajo është në gjendje të demonstrojë njohuritë/aftësitë /sjelljen e nevojshme në mënyrë të kënaqshme, me nevojën e herë pas herëshme për mbështetje nga mentori.

Nota 8 : Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit e ka zotëruar kompetencën në një nivel shumë të mirë. Ai/ajo është në gjendje të demonstrojë njohuritë/ aftësitë /sjelljen e nevojshme, në mënyrë të kënaqshme, pothuajse pa pasur nevojë për mbështetjen e mentorit.

Nota 9: Gjyqtari ose prokurori pjesëmarrës i trajnimit e ka zotëruar kompetencën në nivel të lartë. Ai/ajo është në gjendje të demonstrojë njohuritë/ aftësitë /sjelljen e nevojshme në mënyrë të kënaqshme, dhe plotësisht të pavarur.

